

K O N T R A T E

PER KRIJIMIN E SHOQERISE PRIVATE ME PERGJEGJSI TE  
KUFIZUAR (SH.P.K) "KOHA JONE"

Kjo kontrate u arrit nga:

1-Nikolle Lesi, lindur me date 6 gusht 1963 ne fshatin Spiten te rrethit te Lezhes dhe banues ne lagjen "Gurra", pallati 150/11, Lezhe.

2-Aleksander Frangaj, lindur me date 4 Tetor 1968, ne fshatin Zejmen te rrethit te Lezhes dhe banues ne lagjen "Beslidhja", Lezhe.

Te dy subjektet e mesiperm qe do te quhen ortake bien dakort sa me poshte:

Kjo marreveshje eshte perteritje e akt-marreveshjes se dates 20 (njetzet) Korrik 1992 (njemijeenenteqindenentedhjeteedy) mes dy ortakeve Nikolle Lesi dhe Aleksander Frangaj per themelimin e Shoqerise private "Koha Jone". Perteritja e dokumentave te Themelimit te Shoqerise "Koha jone" eshte e nevojshme te behet nga ndryshimi i disa Ligjeve qe lidhen me aktivitetin privat ne Shqiperi.

NENI 1

Ortaket Nikolle Lesi dhe Aleksander Frangaj formojne Shoqeri me pergjegjsi te kufizuar, SHPK, me emertimin "KOHA JONE".



NENI 2

Shoqeria "Koha jone" e ka qendren e vet ne Lezhe me adrese: Lagja "Beselidhja" dhe dote ushtroj aktivitetin e saj per nje periudhe 50 (pesedhete) vjecare me te drejte rinovimi te ketij afati ne baze te nje marreveshje me shkrim nga ortaket.

NENI 3

Shoqeria eshte person juridik ne baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise, veprimtaria e se ciles rregullohet dhe nga kjo kontrate, statuti qe eshte bashkelidhur me te dhe legjislacioni qe normon kete lloj aktiviteti.

Shoqeria pergjigjet vetem me pasurin e saj e ne asnje rast nuk pergjigjet per detyrimet e marra nga ortaket jashte kushteve te parashikuara ne marreveshje. Ortaket nuk pergjigjen per detyrimet e



Shoqerise dhe nuk perballojne humbjet e saj pertej kuotes se kapitalit te futur ne themelim.

#### NENI 4

Kapitali baze i shoqerise eshte 100000(njeqindmije) leke.Kete kapital ortaket Nikolle Lesi dhe Aleksander Frangaj bien dakort ta ndajne ne keto raporte:

1-Nikolle Lesi	60(gjashtedhete)	per qind
2-Aleksander Frangaj	40(dyzet)	per qind

#### NENI 5

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj shtypjen dhe shperndarjen e gazetes"Koha jone" ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

- Do te ndertoj shtepi botuese dhe shtypshkronja
- Sipas legjislacionit ne fuqi do te ndertoj stacione radiotelevizive private,qendra te prodhimit te filmave dokumentare artistike,shkencore,etj.
- Do te shikoj mundesine per botimin e disa revistave dhe gazetave te tjera.
- Do te ndertoj agjensi te reklamave dhe te turizimit.
- Do te hap kurse per autoshkolla per pergatitjen e kursanteve
- Do te hap njesi tregtare.
- Do te merret me IMPORT-EKSPORT,tregtim te mnallrave me shumice e pakice te te gjitha llojeve.
- Do te hap servise per automjete

#### NENI 6

Kapitali baze i Shoqerise sipas nenit 4(kater) te kesaj kontrate perfaqeson mjetet themelore te xhiros per veprimtarine e saj dhe depozitohen nga ortaket ne Banken e shtetit,ku do te celen dhe llogorite perkatese.

Ne librin e llogorise krijohen fondi themelor i ortakeve ku shenohen kapitalet e vena nga secili ortak.Ortakët nuk kufizohen ne rritjen e kapitalit te tyre.



#### NENI 7

Shoqeria do te filloj aktivitetin e saj pas rregjistrimit ne Gjykatën e Tiranës dhe pajisjes me licence nga organi kompetent ne rrethin e Lezhës.

#### NENI 8

Fitimet neto te realizuar nga Shoqeria,pas zbritjes se shumave per taksat,pagat e shpenzimet e tjera ne perputhje me ligjet ne fuqi do te ndahen mes ortakeve ne menyre proporcionale me pjesmarrjen e tyre ne kapitalin themelor.

#### NENI 9



Secili ortak ka te drejte te heqe dore nga Shoqeria duke njoftuar vendimin e tij Asamblese 3 (tre) muaj perpara. Heqja dore nuk e liron ortakun nga detyrimet e marra me pare ndaj Shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet e Shoqerise ndaj tij.

#### NENI 10

Ortaku doreheges duhet ti ofroj kuoten e tij ortakut tjeter dhe kur ky i fundit nuk e pranon kete blerje, ortak doreheges, brenda 30 (tridhjete) diteve nga dita e njoftimit me shkrim mund ta shese kuoten e tij te treteve, por jo me cmim me te ulet nga ai i ofruar ortakut me shkrim.

#### NENI 11

##### ORGANET E SHOQERISE

- A-Asambleja e ortakeve
- B-Administratori
- C-Organet financiare
- D-Drejtuesit e filialeve

Modalitetet e perberjes dhe funksionet e tyre percaktohen ne menyre te detajuar ne statutin e Shoqerise dhe ne statutet e degeve .

#### NENI 12

Asambleja e ortakeve perbehet nga ortakët themelues Nikolle Lesi dhe Aleksander Frangaj.

#### NENI 13

Administratori i Shoqerise percaktohet nga Asambleja me vendim me shkrim

#### NENI 14

Organet financiare emerohen nga Asambleja e ortakeve

#### NENI 15

Drejtuesit e filialeve te Shoqerise emerohen nga Asambleja me perjashtim te kryeredaktorit te gazetës "Koha jone" , i cili do te zgjidhet nga nje nen i vecante i Statutit te Shoqerise.



#### NENI 16


##### SHTIMI I ORTAKEVE

Kur asambleja unanimisht eshte dakort qe te bej shtese kapitali me ane te personave te tjere, qe keto te konsiderohen ortak, veprohet ne kete menyre:

-Merret vendim me shkrim unanimisht, pasi te jete bere kerkese me shkrim nga i interesuari.

-Pranimi i ortakut te ri behet duke u percaktuar njeheresh edhe kuota e kapitalit qe do derdhe ortak i ardhshem dhe raporti i pergjindjeve qe do te zere ne lidhje me te tjeret.





-Behet rregjistrimi i tij ne Librin e ortakeve,ku shkruhet emri i tij i plote dhe duke kryer te gjitha modalitetet e tjera.

-Veprimi i bashkimit te ortakut te ri behet me akt noterial, ne te cilin duhen te shprehin vullnetin e tyre te lire te gjithe ortakët sebashku.

#### NENI 17

Transferimi i kuotes se kapitalit nuk eshte subjekt i asnje kufizimi. Trashegimtari behet direkt pronar i kapitalit te ortakut te vdekur,duke zbatuar ligjet e pergjithshme te trashegimise

#### NENI 18

Ne rast mosmarreveshjesh lidhur me interpretimin,zbatimin dhe zgjidhjen e kesaj kontrate,kur keto mosmarreveshje nuk mund te zgjidhen me mirekuptim palet i drejtohen Gjykates se rrethit Lezhe ku eshte qendra e kesaj Shoqerie.

#### ORTAKET THEMELUES

NIKOLLE LESI



ALEKSANDER FRANGAJ

